



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT**

VENDIM

Nr. 1 Datë 12 / 09 / 2018

“Për

**Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Basenit Ujor Mat Nr. 63, Datë 22/02/2017, “Për Miratimin e Lejes për Rehabilitimin e Rrjedhës së Ujit në Lumin Mat”,
Subjektit “Elvisi-03” Sh.p.k”.**

Në mbështetje të shkronjës “d”, të nenit 109, nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit, nr. 01, datë 13.01.2010, “Për ndalimin e përkohshëm të dhënies së lejeve të reja për shfrytëzimin e zhavorreve në shtretërit e lumenjve”, vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 01, datë 07.07.2011, “Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve”, me propozimin e Kryetarit, Këshilli i Basenit Ujor Mat;

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 63, datë 22.02.2017, “Për miratimin e Lejes për rehabilitimin e rrjedhës së ujit në lumin Mat”, subjektit “ELVISI-03” sh.p.k
2. Ngarkohet Agjensia e Basenit Ujor Mat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gjergj PRENDI

